

**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I KOSOVËS/ SKUPŠTINA KOSOVA / ASSEMBLY OF KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT/ TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI/ PROCUREMENT REVIEW
BODY**

RAPORTI VJETOR I PUNËS 2009



Shkurt 2010

PRISHTINË

PËRMBAJTJA

HYRJE	3
I. FUNKSIONIMI I INSTITUCIONIT TË ORGANIT SHQYRTUES TË PROKURIMIT	4
Baza ligjore në fuqi.....	4
Parimet mbi të cilat funksionon Organi Shqyrtues i Prokurimit.....	5
Struktura dhe Organogrami i Organit Shqyrtues të Prokurimit.....	6
Trajnimet.....	7
Marrëdhëniet me publikun.....	8
Faqja e internetit.....	9
Buxheti.....	10
II. VEPRIMTARIA E ORGANIT SHQYRTUES TË PROKURIMIT	13
Shqyrtimi i ankesave të prokurimit.....	14
Tabela me të dhënat e Autoriteteve Kontraktuese.....	16
Shqyrtimi i vendimeve të Agjencionit të Prokurimit Publik.....	22
Urdhëresat e shqiptuara ndaj Autoriteteve Kontraktuese.....	25
Paditë e ushtruara në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës ndaj vendimeve të Paneleve Shqyrtuese.....	25
III. OBJEKTIVAT E ORGANIT SHQYRTUES TË PROKURIMIT PËR VITIN 2010	27

HYRJE

Organi Shqyrtues i Prokurimit vjen përpara jush për të prezantuar raportin vjetor të punës për vitin 2009. Gjatë këtij viti, Organi Shqyrtues i Prokurimit është bërë gjithnjë e më efikas në mbrojtjen e interesave ligjore të Operatorëve Ekonomik, por mbi të gjitha në mbrojtje të ligjit, duke rritur kështu besueshmërinë e palëve të interesuara në procedurat e shqyrtimit të ankesave.

Funksioni bazë i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) është garancia më e mirë e zbatimit të Ligjit për Prokurim Publik dhe Ligjit mbi dhënien me koncesion dhe të detyrimeve që rrjedhin prej tyre.

Si organ i pavarur i mandatuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, ai na jep epërsinë për t'i kushtuar vëmendje çështjeve të ankesave të prokurimit publik dhe dhënies me koncesion, duke qenë të paanshëm dhe transparent në dhënien e vendimeve dhe në procedurat e shqyrtimit të ankesave.

Arritjet e punës të pasqyruara në këtë raport, në harkun kohor të vitit 2009, janë fryt i përpjekjeve të Organit Shqyrtues të Prokurimit në evidentimin e parregullsive dhe të shkeljeve të ligjit, në fushën e prokurimit publik.

Gjatë vitit 2009, faqja jonë e internetit u bë burim informacioni për të gjithë të interesuarit, me publikimin e vendimeve që OSHP-ja i nxjerr në përfundim të çdo procesi, që kryhet në bazë të ankesave të pranuar apo me iniciativën e tij, si dhe shkresave të tjera të OSHP-së.

Të gjitha rezultatet e arritura nuk do të ishin të mundura pa punën e punonjësve të Organit Shqyrtues të Prokurimit, të cilët kanë qenë aktiv, profesional dhe të përkushtuar në përmbushjen e detyrave të caktuara me ligj dhe objektivave e angazhimeve që kemi marr përsipër.

I. FUNKSIONIMI I INSTITUCIONIT TË ORGANIT SHQYRTUES TË PROKURIMIT (OSHP)

Baza ligjore në fuqi

Organi Shqyrtues i Prokurimit ushtron aktivitetin e vet mbështetur në:

-Ligjin nr. 02/L-99 Mbi Prokurimin Publik në Kosovë të miratuar nga Kuvendi i Kosovës, dhe në amandamentimin e këtij ligji, sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 2007/20;

-Ligjin nr. 03/L-090, të datës 25.06.2009, Mbi Partneritetet Publiko-Private dhe Koncesionet në Infrastrukturë dhe Procedurat për Dhënien e tyre;

- Ligjin nr. 02/L-28, të datës 25.07.2005, "Mbi Procedurën Administrative",

- Legjislacionin dytësor mbi Prokurimin Publik të KRPP-së dhe

- Rregulloren e Punës së OSHP-së dhe Paneleve Shqyrtuese të datës 17.11.2009 me nr. Prot. 2774/09.

OSHP-ja është institucion i pavarur, i përkushtuar në mbrojtjen e operatorëve ekonomik vendor apo të huaj nga veprimet apo mosveprimet e paligjshme të Autoriteteve Kontraktuese dhe në ndërmarrjet publike në një procedurë prokurimi apo koncesioni.

OSHP bazohet në procesin e vendimmarrjes dhe reflektohet në faktin se:

- Anëtarët e OSHP-së i zgjedh Kuvendi i Republikës së Kosovës në një mandat 5 dhe 4 vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje edhe për një mandat tjetër;
- Anëtarët janë të pavarur dhe
- Nuk angazhohen në asnjë organizatë shoqërore, ekonomike dhe tregtare.

Mbështetur në legjislacionin e mësipërm, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka këto kompetenca:

- Të shqyrtojë procedurat administrative në prokurimin publik dhe dhënien me koncesion brenda kufijve shtetërorë të Republikës së Kosovës;
- Të hetojë, në bazë të ankesave të pranuar apo me iniciativën e tij, veprimet apo mosveprimet e kundërligjshme ose të parregullta të Autoriteteve Kontraktuese;
- Të rekomandojë masa korrigjuese dhe
- Të raportoj drejtpërdrejtë në Kuvendin e Republikës së Kosovës për aktivitetin dhe problematikat që trajton, nëpërmjet analizës vjetore, me kërkesën e Kuvendit, në përputhje me nenin 115 të LPP-ës.

Gjatë hetimit-shqyrtimit të ankesave, OSHP ka të drejtë:

- Të kryejë hetime dhe shqyrtime të procedurave të prokurimit, me qëllim që të ndriçohen faktet që kanë shkaktuar ankesat e tilla;
- Të kërkojë nga çdo person, ndërmarrje ose autoritet publik që të dorëzojë, paraqesë ose mundësojë qasje në të dhënat, informacionet, dokumentet që konsiderohen të rëndësishme për zbatimin e hetimeve ose të procedurave të shqyrtimit të prokurimit;
- Të marr çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin-ankesën;
- Të nxjerr një urdhër ndaj çdo personi për t'u paraqitur në procedurën për shqyrtimin e prokurimit dhe të jap dëshmi dhe
- Të thërras për një seancë dëgjimore në zyrën e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) zyrtarin e prokurimit të Autoritetit Kontraktues si dhe përfaqësuesin e operatorit ekonomik ankues.

Refuzimi i nëpunësve civil, i përfaqësuesve të Autoriteteve Kontraktuese ose i autoriteteve publike për të respektuar vendimin e paneleve shqyrtuese ose për të bashkëpunuar me OSHP-në, përbënë shkak që OSHP-ja të ndërmarr masat ndaj tyre, në përputhje me nenin 118 të LPP-ës.

Parimet mbi të cilat funksionon Organi Shqyrtues i Prokurimit

Gjatë ushtrimit të funksionit të tij, OSHP-ja udhëhiqet nga parimet e përgjithshme, të sanksionuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me Ligjin mbi Procedurën Administrative dhe me zbatimin e plotë të Ligjit mbi Prokurimin Publik, siç janë:

- Paanshmëria;
- Transparenca;
- Mos-diskriminimi dhe barazia në trajtim;
- Pavarësia;
- Profesionalizimi
- Ekonomiciteti dhe efikasiteti.

Organi Shqyrtues i Prokurimit punon në frymën e bashkëpunimit të hapur dhe konstruktiv, me të gjitha institucionet e angazhuara për zbatimin e Ligjit mbi Prokurimin Publik, duke përmendur në radhë të parë: Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP); Agjencionin e Prokurimit Publik (APP); Autoritetet Kontraktuese (AK) dhe Operatorët Ekonomik (OE).

Parimi themelor i punës së OSHP-së është ligjshmëria dhe transparenca, nëpërmjet mjeteve të komunikimit me publikun, siç është uebfaqja e OSHP-së (www.ks-gov.net/oshp), mjetet e tjera të telekomunikimit si dhe ato të shkruara.

Organi Shqyrtues i Prokurimit siguron gjithashtu të drejtën për të informuar publikun dhe njëkohësisht mundëson kushte për marrjen e informacionit mbi dokumentet zyrtare në fushën që mbulon.


Struktura dhe Organogrami i Organit Shqyrtues të Prokurimit

Struktura e Organit Shqyrtues të Prokurimit është e përbërë nga Kryetari dhe katër (4) anëtarët e Paneleve Shqyrtuese, si dhe stafi mbështetës. Në funksion të organizimit, Organi Shqyrtues i Prokurimit miratoi Rregulloren e Punës së OSHP-ës dhe Paneleve Shqyrtuese të datës 17.11.2009 me nr. të Prot. 2774/09, në të cilën përcaktohen qartë detyrat e Kryetarit të OSHP-ës dhe të anëtareve të Paneleve Shqyrtuese, si dhe procedurat e komunikimit ndërmjet tyre.

Struktura dhe Organogrami i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP)



ORGANOGRAMI I ORGANIT SHQYRTUES TË PROKURIMIT



TRAJNIMET

Organi Shqyrtues i Prokurimit gjatë vitit 2009 i ka kushtuar një vëmendje të veçantë ngritjes së kapaciteteve profesionale të organit nëpërmjet trajnimeve në vende të ndryshme.

Trajnimet kanë ndikuar në ngritjen profesionale të anëtarëve të Paneleve Shqyrtuese dhe të stafit të Organit Shqyrtues të Prokurimit, në lëmin e Prokurimit Publik dhe Ligjit për Partneritet Publiko-Privat dhe Koncesionet në Infrastrukturë dhe Procedurat për dhënien e tyre.

Kështu mund të cekim trajnimet si në vijim:

Shkurt 2009 - "ILO" në Torino-Itali;

Mars 2009 - Tema: Zhvillimi, vlerësimi i procesit të prokurimit publik në Kosovë – Bashkimin Evropian;

Maj 2009 - "Konferenca rajonale mbi prokurimin publik", Dubrovnik – Kroaci;

Qershor 2009 - "Instituti Evropian për Administratë Publike", Holandë,

Tema: "Zhvillimet e fundit në Prokurimin Publik në Evropë - mjetet juridike dhe reformat në jurisprudencë";

Shtator 2009 - "Instituti Evropian për Administratë Publike", Holandë,

Tema: "Rregullat e Prokurimit Publik, Politikat dhe Praktikrat Evropiane".

Shtator 2009 - Durrës–Shqipëri,

Tema "Praktikat më të mira të Prokurimit Elektronik";

Nëntor 2009 - "Kopenhagë–Danimarkë",

Tema "Vizitë Studimore Institucioneve të Prokurimit Publik në Danimarkë", mbështetur nga kompania "Planet"-BE.

Dhjetor 2009 - Ohër–Maqedoni

Tema "Hartimi i Shkresave Zyrtare"

MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN

Objektiv i punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2009 ka qenë dhe mbetet informimi dhe ndërgjegjësimi i publikut dhe i operatorëve ekonomik për funksionin dhe shërbimet që ne i ofrojmë.

Konsolidimin e marrëdhënieve me publikun e kemi përqendruar në tri drejtime të komunikimit: së pari, ndërmjet mediave të cilave iu kemi ofruar materiale të mbështetura në çështje konkrete; së dyti, nëpërmjet takimeve me operatorët ekonomik dhe palët e interesuara dhe, së treti, nëpërmjet faqes së përditshme të internetit, në të cilën pasqyrohet aktiviteti i tërësishëm i punës së OSHP-së. Marrëdhëniet me mediat kanë pasur prioritet për përmbushjen e objektivave për të rritur besueshmërinë e operatorëve ekonomik dhe të publikut ndaj OSHP-ës. Nga ky bashkëpunim kemi forcuar imazhin si dhe pozicionin e Organit Shqyrtues të Prokurimit kundruall opinionit publik, duke e krijuar integritetin e nevojshëm për realizimin e komunikimit me ta. Rritja e besimit të operatorëve ekonomik ndaj Organit Shqyrtues të Prokurimit është mbështetur në shqyrtimin e ankesave dhe në marrjen e vendimeve në mënyrë profesionale, të paanshme dhe në afatin e paraparë ligjor.

Organi Shqyrtues i Prokurimit i ka kushtuar një rëndësi të veçantë pritjes së operatorëve ekonomik dhe publikut në çdo kohë pa pengesa dhe me etikë profesionale. Zyra për pranimin dhe trajtimin e ankesave ka mirëpritur palët ankimore, parashtrësat e tyre, dhe, njëherazi, ka bërë sqarime të nevojshme rreth pyetjeve dhe paqartësive të Operatorëve ekonomik lidhur me PJESA VIII të Ligjit mbi Prokurimin Publik.

FAQJA E INTERNETIT

Në fillim të vitit 2009 është krijuar uebfaqja e Organit Shqyrtues të Prokurimit – (www.ks-gov.net/oshp), që përmban të gjitha informatat e duhura për operatorët ekonomik dhe për të gjitha palët e interesuara. Të gjithë vizitorët gjejnë në faqen tonë të internetit informacion të larmishëm mbi rolin dhe funksionet e OSHP-se, njoftimet mbi vendimet e Paneleve Shqyrtuese, aktvendimet, urdhëresat si dhe informacione rreth funksionimit të OSHP-ës.

Uebfaqja përmban tri shtylla kryesore të cilat janë:

Rreth OSHP-së: Në këtë link gjenden të gjitha informatat që kanë të bëjnë me veprimtarinë e OSHP-së, bazën ligjore, siç është: Ligji mbi Prokurimin Publik nr. 02/L-99, Rregullorja e Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit dhe Paneleve Shqyrtuese nr. 2774/09, Qarkorja nr. 1 2009/01 si dhe Qarkorja nr. 2 2009/02.

Pjesa më e rëndësishme dhe më e klikuar nga vizitorët është linku Publikimet, në të cilën gjendet nën-linku – Vendimet. Pas përfundimit të çdo seance shqyrtuese, vendimet e panelit shqyrtues publikohen në këtë link, ku në mënyrë transparente gjenden të gjitha informatat e nevojshme siç janë: aktiviteti i prokurimit, Autoriteti Kontraktues i cili ka zhvilluar procedurën e prokurimit, operatori ekonomik ankues si dhe të gjitha provat apo faktet që kanë qenë vendimtare me rastin e marrjes së vendimit. Çdo vendim i marrë është lehtësisht i shkarkueshëm duke e bërë punën tonë 100% transparente. Në këtë pjesë gjenden të gjitha vendimet e lëshuara nga Panelet shqyrtuese në gjuhën shqipe, angleze dhe serbe.

Ndërsa, në anën e djathtë të uebfaqes, gjendet pjesa e arkivit, në të cilën arkivohen të gjitha vendimet e lëshuara nga OSHP-ja.

Përmes uebfaqes, Organi Shqyrtues i Prokurimit, i ofron informata publikut, operatorëve ekonomik si dhe institucioneve të Republikës së Kosovës - një dritare e vlefshme për t'u njohur me aktivitetin dhe punën e OSHP-së.

Buxheti

Buxheti i OSHP-së për vitin 2009 ka pasur rritje në krahasim me gjashtëmujorin e dytë të buxhetit të vitit 2008, në kategorinë e Pagave dhe të mëditjeve, në kategorinë e Investimeve kapitale si dhe në kategorinë e Mallrave dhe shërbimeve. Buxheti në vlerë prej 526,071.00 euro ka qenë i mjaftueshëm për krijimin e kushteve, konsolidimin dhe funksionimin e Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Buxheti është realizuar në mënyrë efikase dhe atë si më poshtë: në kategorinë e Pagave dhe mëditjeve janë shpenzuar 71.51% e buxhetit; në kategorinë e Investimeve kapitale 83.67%; në kategorinë e Mallrave dhe shërbimeve 57.84%; në kategorinë e Shpenzimeve komunale 23,58% etj., siç paraqitet në tabelën si në vijim. Sidoqoftë, gjatë vitit buxhetor 2009, është bërë i mundur rekrutimi i shërbyesve civil, realizimi i prokurimeve, lidhja e kontratave për furnizime, shërbime etj., duke siguruar ambient dhe kushte normale për funksionimin e OSHP-së.

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT - 240/159000								
RAPORTI SINTETIK (PËRMBLEDHËS) I BUXHETIT TË ZOTUAR DHE TË SHPENZUAR PËR PERIU DHËN JANAR - 31 DHJETOR/2009								
1	2	3	4	5	6	7	8	9
Kod. Ekon.	Kategoritë Ekonomike	Buxheti Vjetor 2009	Buxheti i alokuar	Zotimet deri më 31 Dhjetor/2009	Shpenzimet deri më 31 Dhjetor/2009	Të pazotuar (4 - 5)	% e buxhetit të zotuar (5/3)	% e buxhetit të shpenzuar (6/3)
011110	Paga dhe mëditje	132,571.00	132,571.00	94,800.73	94,800.73	37,770.27	71.51	71.51
	Punëtorët në listën e pagave	132,571.00	132,571.00	94,800.73	94,800.73			
	Mëditje							
013000	Mallra dhe shërbime	269,000.00	269,000.00	237,756.73	155,586.62	31,243.27	88.39	57.84
13100	Shpenzimet e udhëtimit	6,000.00		2,000.00	430.53			
13130	Shpenzimet të drejtpërdrejta brenda vendit	2,000.00						
13140	Shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit (bileta të udhëtimit etj.)	4,000.00		2,000.00	430.53			
13300	Shërbimet e telekomunikimit	16,000.00		5,710.00	5,330.00			
13310	Shpenzimet për internet	2,500.00		240.00	0.00			
13320	Shpenzimet e tjera telefonike (Mbushjet e telefonave)	9,500.00		5,470.00	5,330.00			
13330	Shpenzimet e tjera të komunikimit (Pullat Postare)	1,500.00						
13340	Shpenzimet për përdorimin e kabllor optike	2,500.00						
13400	Shpenzimet për shërbime	124,500.00		108,635.00	83,724.24			
13410	Shërbimet e arsimit dhe trajnimit	7,000.00		22,420.00	19,420.00			

13440	Shërbimet e ndrysh. intelek. dhe këshill.	95,000.00	65,000.00	50,726.00			
13450	Shërbimet e shtypjes - jo marketing	12,000.00	299.00	147.00			
13460	Shërbimet e tjera kontraktuese të kohëpaskohshme (punëtorët me kontratë)	9,000.00	20,916.00	13,431.24			
13495	Vendime Gjyqësore						
13470	Shërbime teknike	1,500.00					
13500	Blerja e mobiljeve dhe e pajisjeve < 1000	29,500.00	14,798.00	9,626.88			
13501	Mobilje	11,000.00					
13502	Telefona	2,500.00	2,000.00	1,983.00			
13503	Kompjuter	15,000.00	3,594.00	2,678.48			
13504	Harduer për TI	1,000.00					
13505	Aparat Fotokopjues						
13509	Pajisje të tjera		9,204.00	4,965.40			
13550	Blerja e mobiljeve dhe e pajisjeve > 1000						
13551	Mobilje						
13552	Telefona						
13553	Kompjuter mbi 1000 euro						
13554	Harduer për TI						
13555	Makina fotokopjuese						
13559	Pajisje të tjera mbi 1000 euro						
13600	Blerje të tjera	27,000.00	18,920.28	7,932.19			
13610	Furnizime për zyrë	14,000.00	18,920.28	7,932.19			
13620	Furnizimi me ushqim dhe pije	13,000.00					
13640	Furnizime për higjienë						
13650	Furnizime për veshmbathje						
13660	Shpenzimet e Akomodimit						
13700	Derivatet dhe lëndët djegëse	26,000.00	7,911.86	3,706.02			
13770	Derivate për gjenerator	10,000.00					
13780	Karburante për vetura	16,000.00	7,911.86	3,706.02			
13800	Llogaritë e avansit	0.00	51,400.00	33,376.27			
13820	Avans për udhëtime zyrtare		48,900.00	31,236.84			
13810	Avans për shuma të vogla parash të gatshme dhe rimbushje		2,500.00	2,139.43			
13910	Provizioni bankar	300.00		0.00			
13914	Provizioni bankar-BRK			0.00			
13950	Sigurimi i automjeteve dhe regjistrimi i tyre	4,000.00	2,073.95	921.79			
13951	Sigurimi i automjeteve dhe regjistrimi i tyre	4,000.00	2,073.95	921.79			
14000	Mirëmbajtja dhe riparimi	17,000.00	9,149.54	2,851.82			
14010	Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	8,000.00	8,913.50	2,615.78			
14020	Mirëmbajtja e ndërtesave	6,000.00	99.76	99.76			
14040	Mirëmbajtja e teknologjisë informative	3,000.00	136.28	136.28			
14050	Mirëmbajtja e orendive dhe e pajisjeve të tjera						
14100	Qiraja	0.00	0.00	0.00			
14110	Qiraja për ndërtesa						

14200	Shpenzimet e reklamave dhe të marketingut	10,500.00		10,186.60	4,624.68			
14210	Konkurset dhe shpalljet në gazeta	6,000.00		10,186.60	4,624.68			
14220	Publikimet	3,000.00						
14230	Shpenzimet e informimit publik	1,500.00						
14300	Shpenzimet e përfaqësimit	7,000.00		6,971.50	3,062.20			
14310	Drekat dhe pijet zyrtare	7,000.00		6,971.50	3,062.20			
14400	Shpenzimet e tjera	1,200.00						
14430	Shpenzimet për vendimet gjyqësore	1,200.00						
13200	Shpenzimet për shërbimet komunale	17,000.00	17,000.00	9,615.51	4,008.59	7,384.49	56.56	23.58
13210	Shpenzimet e energjisë elektrike	5,000.00		4,536.18	1,536.18			
13220	Shpenzimet e ujit	2,000.00						
13230	Shpenzimet për mbeturina	1,500.00						
13240	Shpenzimet për ngrohje	3,000.00						
13250	Shpenzimet e telefonit fiks dhe roming PTK	5,500.00		5,079.33	2,472.41			
030000	Investime kapitale	105,000.00	105,000.00	96,300.00	87,855.56	8,700.00	91.71	83.67
31700	Blerja e automjeteve	-		86,300.00	86,300.00			
31110	Përvetësimi i pasurive kapitale fikse							
31510	Struktura të tjera							
31900	Kapital tjetër							
31600	Pajisje të tjera mbi 1000 euro			10,000.00	1,555.56			
021000	Transfere dhe Subvencione	2,500.00	2,500.00	0.00	0.00			
021000	Transfere dhe Subvencione	-		-	-			
	Totali i buxhetit	526,071.00	526,071.00	438,472.97	342,251.50	87,598.03	83.35	65.06

II. VEPRIMTARIA E ORGANIT SHQYRTUES TË PROKURIMIT

Shqyrtimi i ankesave të palëve të interesuara (operatorëve ekonomik), që i drejtohen Organit Shqyrtues të Prokurimit, bëhet nga Panelet Shqyrtuese në përbërje prej një anëtari ose tre anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit. Ndërsa në rastet kur lënda, e cila është në shqyrtim, është e rëndësishë apo e interesit të veçantë, paneli shqyrtues përbëhet prej pesë anëtarëve të OSHP-së.

Paneli shqyrtues emërohet nga Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP).

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së ankesave të parashtuara, Panelet Shqyrtuese, duke u bazuar në nenet 102.1, 102.2 si dhe 112.2 të LPP-ës, në ekspertizat e ekspertëve dhe në seancat dëgjimore, nxjerrin këto vendime:

1. Aprovimin e aktiviteteve të prokurimit, kur Autoriteti Kontraktues nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LPP-ës;
2. Rivlerësimin e aktivitetit të prokurimit, nëse komisioni vlerësues i Autoritetit Kontraktues gjatë vlerësimit nuk i është përmbajtur kritereve të caktuara në dosjen e tenderit dhe nuk ka bërë vlerësim objektiv;
3. Anulimin e aktivitetit të prokurimit, atëherë kur Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të procedurave të prokurimit gjatë zhvillimit të aktivitetit të prokurimit dhe
4. Refuzimin e ankesave, atëherë kur ankesat janë të pakompletuara, sepse operatorët ekonomik nuk iu kanë përmbajtur afateve për parashtrim të ankesës ose kanë dështuar në ofrimin e deponimit të sigurimit të ankesës apo me rastin e tërheqjes së operatorit ekonomik ankues.


Funksionimi i punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit, përveç se është i paraparë me ligj, siguron mbrojtjen e operatorëve ekonomik ankues, por gjithashtu garanton që procedurat e prokurimit publik të zhvillohen me respektimin e plotë të parimeve bazë, siç janë transparenca, trajtimi i barabartë dhe jo-diskriminues i ofertuesve si dhe shfrytëzimi i drejtë i fondeve publike.

SHQYRTIMI I ANKESAVE TË PROKURIMIT

Gjatë vitit 2009, në Organin Shqyrtues të Prokurimit janë pranuar gjithsejtë 542 ankesa nga operatorët ekonomik dhe Autoritetet Kontraktuese, të cilët nuk kanë qenë të kënaqur me vendimet e Autoriteteve Kontraktuese dhe të Agjencionit të Prokurimit Publik.

Pretendimet e palëve ankimore kryesisht kanë të bëjnë me shkeljet e Ligjit mbi Prokurimin Publik të Kosovës dhe legjislacionit dytësor, gjegjësisht Rregullores së Prokurimit Publik / Pjesa B, në vendimet e Autoriteteve Kontraktuese gjatë procesit të vlerësimit të aktivitetit të prokurimit.

Në vazhdim po paraqesim në formë grafike numrin e ankesave dhe të kërkesave për rishqyrtimin e vendimeve të APP-ës, nga OSHP-ja për vitin 2009.



Grafiku nr. 1 (Lëndët e shqyrtuara - 2009)

Prej gjithsejtë 542 ankesave të pranuar, 457 janë ankesa të parashtruara nga operatorët ekonomik kundër vendimeve të autoriteteve kontraktuese për dhënien e kontratës, ndërsa 85 ankesa janë të autoriteteve kontraktuese për rishqyrtimin e vendimeve të APP-së .

Për procedurat e shqyrtimit të ankesave të prokurimit publik gjatë vitit 2009, po paraqesim të dhënat sintetike dhe analitike të punës sonë si në vijim:

Prej gjithsejtë 457 ankesave të pranuar:

- Në shqyrtim nga Organi Shqyrtues i Prokurimit janë trajtuar 347 ankesa të parashtruara nga operatorët ekonomik, të cilat i kanë plotësuar kushtet ligjore për shqyrtim, në pajtim me nenet 105,106 dhe 113 të LPP-ës;

- Paneli shqyrtues, nga 219 ankesa të shqyrtuara, ka aprovuar vendimin e Autoriteteve Kontraktuese, si të bazuara duke konstatuar se pretendimet e palëve ankimore nuk përmbajnë bazë ligjore që të aprovohen ankesat e tyre;
- Në 73 raste, paneli shqyrtues ka marrë vendim për rivlerësimin e ofertave, duke hasur në shkeljet e caktuara të LPP-ës, gjatë procedurës së vlerësimit të ofertave.
- Në 55 raste, Paneli Shqyrtues ka marrë vendim për anulimin e aktivitetit të prokurimit (Ri-tender), atëherë kur Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të procedurave të prokurimit gjatë zhvillimit të aktivitetit të prokurimit;
- 96 ankesa janë hedhur poshtë për shkak të mos-kompletimit të ankesës brenda afatit ligjor në pajtim me nenet 106.4 dhe 113.1 të LPP-ës dhe
- Para se të merren në shqyrtim nga Paneli Shqyrtues, 14 ankesa të dorëzuara janë tërhequr nga operatorët ekonomik ankues.

Pra, përfundojmë se në të gjitha rastet e shqyrtimit të ankesave, të kryera nga Panelet Shqyrtuese, procedurat e shqyrtimit kanë përfshirë verifikimin e të gjitha dokumentacioneve të tenderit. Shqyrtimi i ankesave nuk ka përfshirë vetëm pretendimet e ankuesit, por edhe aktivitetin e prokurimit duke përfshirë: autorizimin e aktivitetit të prokurimit, njoftimin për kontratë, vendimin mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, të procesverbalit mbi hapjen e ofertave, raportin e vlerësimit të ofertave, njoftimin mbi dhënien e kontratës si dhe pretendimet ankimore të palës ankuese.

Shkeljet ligjore dhe parregullsitë e përsëritura nga ana e Autoriteteve Kontraktuese janë gjetur veçanërisht në disa nga aspektet më të rëndësishme të zhvillimit të procedurave të prokurimit publik. Paneli shqyrtues në shumicën e rasteve ka hasur në parregullsi gjatë procesit të vlerësimit të ofertave dhe në marrjen e vendimeve të gabuara për shpalljen e fituesit. Gjithashtu janë konstatuar shkelje të Ligjit mbi Prokurimin Publik, gjë që ka ndikuar që njoftimet për dhënie të kontratës të Autoriteteve Kontraktuese të anulohen apo që lënda të kthehet në rivlerësim nga ana e Paneleve Shqyrtuese.


TABELA ME TË DHËNAT E AUTORITETEVE KONTRAKTUESE

Nr	Autoriteti Kontraktues	Ankesa të pranuar	Lëndët e shqyrtuara	Aprovim	Ri-vlerësim	Ri-tenderim	Flakje	Tërheqje
1	Kuvendi i Kosovës	4	4	4	/	/	/	/
2	Zyra e Kryeministrit	1	1	1	/	/	/	/
3	Ministria e Administratës Publike	27	26	15	4	7	1	/
4	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	6	5	4	1	/	1	/
5	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	12	9	5	3	1	2	1
6	Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës	13	11	8	3	/	2	/
7	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	3	2	2	/	/	1	/
8	Ministria e Drejtësisë	7	6	6	/	/	1	/
9	Ministria e Shëndetësisë	23	21	13	6	2	2	/
10	Ministria e Ekonomisë dhe Financave	6	5	2	1	2	1	/
11	Ministria e Punëve të Brendshme	8	7	6	1	/	1	/
12	Ministria e Energjetikës dhe Minerave	3	3	3	/	/	/	/
13	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	8	4	2	2	/	3	1
14	Ministria për Kthim dhe Komunitete	3	3	3	/	/	/	/
15	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	9	8	2	1	5	1	/
16	Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit	16	9	6	/	3	5	2
17	Ministria e Arsimit Shkencës dhe e Teknologjisë	30	15	9	5	1	7	8
18	Ministria e Arsimit Shkencës dhe e Teknologjisë/Danida	2	2	/	2	/	/	/

Nr	Autoriteti Kontraktues	Ankesa të pranuar	Lëndët e shqyrtuara	Aprovim	Ri-vlerësim	Ri-tenderim	Flakje	Tërheqje
19	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	5	4	2	2	/	1	/
20	KK-Prishtinë	11	6	6	/	/	5	/
21	KK-Prizren	13	10	6	3	1	3	/
22	KK-Pejë	3	3	3	/	/	/	/
23	KK-Mitrovicë	2	1	/	1	/	1	/
24	KK-Gjilan	5	3	/	2	1	2	/
25	KK-Ferizaj	7	7	3	2	2	/	/
26	KK-Gjakovë	2	2	1	/	1	/	/
27	KK-Suharekë	10	9	7	1	1	1	/
28	KK-Rahovec	8	8	4	4	/	/	/
29	KK-Vushtrri	3	1	1	/	/	2	/
30	KK-Shtime	1	1	/	/	1	/	/
31	KK-Deçan	1	1	1	/	/	/	/
32	KK-Klinë	4	3	3	/	/	1	/
33	KK-Dragash	1	1	1	/	/	/	/
34	KK-Podujevë	10	6	4	2	/	3	1
35	KK-Malishevë	1	/	/	/	/	1	/
36	KK-Viti	6	4	3	/	1	2	/
37	KK-Lipjan	2	1	/	1	/	1	/
38	KK-Obiliq	3	2	2	/	/	1	/
39	KK-Skenderaj	1	1	1	/	/	1	/

Nr	Autoriteti Kontraktues	Ankesa të pranuar	Lëndët e shqyrtuara	Aprovim	Ri-vlerësim	Ri-tenderim	Flakje	Tërheqje
40	KK-Shtërpce	4	2	/	2	/	2	/
41	KK-Istog	3	3	3	/	/	/	/
42	KK-Fushë Kosovë	5	4	3	1	/	1	/
43	KK-Zveçan	1	/	/	/	/	1	/
44	Agjencioni i Prokurimit Publik	4	4	4	/	/	/	/
45	Zyra e Auditorit Gjeneral	1	/	/	/	/	1	/
46	Agjencioni Kosovar i Privatizimit	1	1	/	/	1	/	/
47	Agjencioni Kosovar i Pronave	3	3	2	/	1	/	/
48	Administrata Tatimore e Kosovës	6	4	4	/	/	2	/
49	Policia e Kosovës	15	9	7	2	/	6	/
50	Korporata Energjetike e Kosovës	40	32	18	3	11	8	/
51	"KOST"	2	2	2	/	/	/	/
52	Posta dhe Telekom i Kosovës	18	12	8	4	/	6	/
53	Aeroporti ndërkombëtarë i Prishtinës	4	3	2	1	/	1	/
54	Trepça	1	/	/	/	/	1	/
55	Termokos	4	3	1	/	2	1	/
56	KRM Higjiena-Prishtinë	2	1	1	/	/	1	/
57	Kompania e Ujësjellësit Rajonal-Prishtinë	2	2	2	/	/	/	/
58	KRM Higjiena Gjilan	2	2	2	/	/	/	/
58	Hidro-regjioni "Radoniçi" Gjakovë	1	1	1	/	/	/	/
59	KRM Pastrimi-Prishtinë	2	2	1	/	1	/	/

Nr	Autoriteti Kontraktues	Ankesa të pranuar	Lëndët e shqyrtuara	Aprovim	Ri-vlerësim	Ri-tenderim	Flakje	Tërheqje
60	Hidro Regjioni Prizren	1	1	/	1	/	/	/
61	Doganat e Kosovës	3	1	/	1	/	2	/
62	Shkolla Policore Vushtrri	1	1	/	1	/	/	/
64	Universiteti i Prishtinës	4	3	2	1	/	1	/
65	Qendra e Studentëve	3	2	2	/	/	1	/
66	Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës	9	3	/	2	1	5	1
67	Enti Statistikor i Kosovës	1	1	1	/	/	/	/
68	QKMF-Prishtinë	1	1	/	/	1	/	/
69	QKMF-Prizren	2	2	1	1	/	/	/
70	QKMF-Podujevë	1	1	/	/	1	/	/
71	QKUK	10	10	5	4	1	/	/
72	Spitali Rajonal Pejë	6	6	1	2	3	/	/
73	Spitali Sheik Zayd-Vushtrri	1	1	1	/	/	/	/
74	Spitali Rajonal Prizren	2	1	/	/	1	1	/
75	IKSHPK	1	1	1	/	/	/	/
76	Radio Televizioni i Kosovës	4	4	3	/	1	/	/
77	Sekretariati i Komisionit Qendror Zgjedhor	2	2	2	/	/	/	/
78	Agjencioni i Veterinarisë dhe Ushqimit të Kosovës	3	1	/	/	/	2	/
79	CDF	1	/	/	/	/	1	/
	Totali	457	347	219	73	55	96	14



Grafiku nr. 2 (Përqindja e vendimeve të Paneleve Shqyrtuese)

Në vazhdim po paraqesim skemën, duke i klasifikuar ankesat në bazë të vlerës:



Gjatë vitit 2009, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka trajtuar 457 ankesa të parashtruara nga ana e operatorëve ekonomik kundër vendimeve të Autoriteteve Kontraktuese për dhënie

të kontratës, pa i llogaritur 85 ankesat e autoriteteve kontraktuese për rishqyrtim të vendimeve të APP-ës, ndërsa për vitin 2008 ky organ ka trajtuar dhe shqyrtuar 290 ankesa.

Ky është një indikator i qartë që tregon se besueshmëria e operatorëve ekonomik në mbrojtjen e të drejtave të tyre ligjore nga ana e Organit Shqyrtues të Prokurimit është rritur, nga fakti se numri i ankesave të parashtruara për vitin 2009 është për 61% më shumë, në krahasim me vitin 2008.




SHQYRTIMI I VENDIMEVE TË AGJENCIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Autoritetet Kontraktuese të pakënaqura me vendimet e Agjencionit të Prokurimit Publik, në pajtim me nenet 95.2 dhe 30A. 6 të Ligjit nr. 02/L-99 mbi Prokurimin Publik, kanë parashtruar në OSHP kërkesa për rishqyrtimin e vendimeve të APP-ës, të cilat kërkesa kanë të bëjnë me moslejimin e përdorimit të procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë apo revokim të nenit 30 A. 4 të LPP-ës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka shqyrtuar gjithsejtë 85 kërkesa të Autoriteteve Kontraktuese. Kërkesat e bëra kanë të bëjnë pikërisht me rishqyrtimin e vendimeve të APP-ës, për moslejimin e përdorimit të procedurave të negociuara pa publikim të njoftimit për kontratë apo revokim të nenit 30. A. 4 të LPP-ës.

- 17 Kërkesat e bëra nga Autoritetet Kontraktuese në OSHP, kanë të bëjnë me kërkesën për revokim të nenit 30A. 4;
- 68 Kërkesa kanë të bëjnë me lejimin e përdorimit të procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë;
- Ku 59 prej tyre janë të aprovuara dhe
- 26 nga kërkesat e rishqyrtuara janë refuzuar nga ana e Organit Shqyrtues të Prokurimit, për faktin se Panelet Shqyrtuese nuk kanë gjetur shkelje nga ana e APP-ës, dhe se vendimet e tyre kanë qenë të drejta dhe të bazuara në dispozitat e LPP-ës.



Grafiku. 3.(Shqyrtimi i vendimeve të APP-ës)

TABELA E SHQYRTIMIT TË VENDIMEVE TË AGJENCIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK
Periudha: Janar-Dhjetor 2009

Nr	Autoriteti Kontraktues	Kërkesa të AK-së	Revokim neni 30A.4	Procedurë e negociuar (pune shtesë) sipas neni 34	Nr. i kërkesave të aprovuara të AK-së	Nr. i kërkesave të refuzuara të AK-së
1	Posta dhe Telekom i Kosovës	5	1	4	3	2
2	Aeroporti Ndërkombëtarë i Prishtinës	5	3	2	5	/
3	Ndërmarrja Publike Banesore	1		1	1	/
4	KK-Skenderaj	1	1	/	1	/
5	Korporata Energjetike e Kosovës	3	1	2	3	/
6	Policia e Kosovës	6	1	5	6	/
7	KK-Prizren	1	1	/	1	/
8	KK-Vushtri	1	/	1	1	/
9	KK-Dragash	1	/	1		1
10	KK-Obiliq	1	/	1	/	1
11	KK-Suharekë	1	/	1	1	/
12	KK-Lipjan	1	/	1	1	/
13	KK-Istog	1	/	1	1	/
14	Kuvendi i Kosovës	1	/	1	1	/
15	Administrata Tatimore e Kosovës	1	/	1	/	1
16	Ministria e Punëve të Brendshme	1	/	1	1	/
17	Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit	21	1	20	15	6
18	Universiteti i Prishtinës	1	1	/	1	/
19	Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë	10	/	10	6	4

Nr	Autoriteti Kontraktues	Kërkesa të AK-së	Revokim neni 30A.4	Procedurë e negociuar (punë shtesë) sipas neni 34	Nr. i kërkesave të aprovuara të AK-së	Nr. i kërkesave të refuzuara të AK-së
20	Ministria e Shëndetësisë	2	1	1	2	/
21	Qendra Klinike Universitare e Kosovës	1	/	1	1	/
22	Sekretariati i Këshillit Qendror Zgjedhor	8	/	8/	/	8
23	Agjencioni i Veterinarisë dhe Ushqimit të Kosovës	1	/	1	1	/
24	KK Drenas	1	/	1	1	/
25	KK Klinë	2	/	2	2	/
26	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	1	1	/	1	/
27	Ministria e Tregtisë Industrisë	1	/	1	1	/
28	Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës	1	/	1	1	/
29	Iber Lepenci	1	1	/	1	/
30	Radio Televizioni i Kosovës	3	3	/	1	2
Totali		85	16	69	59	26

Urdhëresat e shqiptuara ndaj Autoriteteve Kontraktuese

Duke u nisur nga ankesat e operatorëve ekonomik, Organi Shqyrtues i Prokurimit në disa lëndë ka rekomanduar Autoritetet Kontraktuese që aktivitetin e prokurimit ta kthejnë në Ri-vlerësim, për shkak të mosrespektimit të LPP-ës. Në disa raste Autoritetet Kontraktuese nuk kanë respektuar vendimin e Paneleve Shqyrtuese për Ri-vlerësimin e ofertave.

Me LPP-në përcaktohet qartë se vendimet e Organit Shqyrtues të Prokurimit, pas shqyrtimit të ankesave, janë përfundimtare, mirëpo disa Autoritete Kontraktuese kanë zvarritur procedurat e prokurimit publik apo nuk e kanë respektuar vendimin për rivlerësimin e ofertave, në disa raste duke ardhur deri te anulimi i aktivitetit të prokurimit apo edhe duke e shpërblyer të njëjtin operator ekonomik me kontratë. Veprimet e këtilla përbëjnë shkelje të LPP-ës, e njëkohësisht kanë edhe efekt negativ në shfrytëzimin e fondeve publike.

Rastet, në të cilat Organi Shqyrtues i Prokurimit ka shqiptuar urdhëresa ndaj Autoriteteve Kontraktuese për mosrespektimin e vendimeve të Paneleve Shqyrtuese, janë si në vijim: Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Tregtisë dhe e Industrisë, Ministria e Forcës së Sigurisë, Ministria e Administratës Publike, KK. Prishtinë, KK. Gjilan, KK. Ferizaj dhe KK. Rahovec.

Autoriteti kontraktues që nuk ka pasur fare bashkëpunim dhe që OSHP nuk ka pasur mundësi të ketë qasje në lidhje me dërgimin e vendimit për pezullim të aktivitetit të prokurimit është KK Zveçan.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, në bazë të nenit 118 të LPP-ës ka shqiptuar masën ndëshkuese për mosrespektimin e vendimit të Panelit Shqyrtues ndaj Autoritetit Kontraktues KK. Rahovec dhe menaxherit të prokurimit, kurse Autoritetet e tjera kontraktuese, pas urdhëresës së OSHP-së për shqiptimin e sanksioneve, kanë respektuar në tërësi vendimet e OSHP-së.


Paditë e ushtruara në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës ndaj vendimeve të Paneleve Shqyrtuese

Për vendimet e marra nga Panelet Shqyrtuese, operatorët ekonomik ankues, jo në të gjitha rastet kanë qenë të kënaqur dhe nga ky shkak kanë vazhduar procedurat me padi në Gjykatën Supreme të Republike së Kosovës.

Nga gjithsejtë 457 ankesat të pranuar, për tetë (8) lëndë është iniciuar procedurë përmes padisë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës nga ana e operatorëve ekonomik ankues, të cilët kanë qenë të pakënaqur me vendimet e OSHP-së si në vijim:

- Në një padi të ushtruar nga operatori ekonomik kundër vendimit të Panelit Shqyrtues, Gjykata Supreme e Kosovës e ka aprovuar vendimin e Panelit Shqyrtues, duke mos gjetur asnjë shkelje nga ana e OSHP-ës në procesin e vendimmarrjes.

- Në një rast, Gjykata Supreme e Kosovës ka marrë aktvendim, me të cilin aprovohet padia e operatorit ekonomik ankues, të ushtruar kundër vendimit të Panelit Shqyrtues.
- Për rastet e tjera të cekura më lartë, Gjykata Supreme e Kosovës ende është duke zhvilluar procedurë gjyqësore.



III. OBJEKTIVAT E ORGANIT SHQYRTUES TË PROKURIMIT PËR VITIN 2010

Synimet e Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2010 shtrihen në disa sfera, përkatësisht në lëmin e prokurimit publik, për partneritet publik dhe privat dhe dhënie me koncesion, e që janë vazhdimësi e objektivave të prezantuara në raportin e vitit 2008 si në vijim:

- Edhe më tej do të vazhdojmë me rritjen e besimit të operatorëve ekonomik, duke punuar në mënyrë të paanshme dhe në suaza ligjore.
- Do të vazhdojmë të forcojmë kapacitetet administrative në drejtim të profesionalizmit të vet anëtarëve të OSHP-ës dhe të stafit të administratës mbështetëse, përmes trajnimeve të organizuara nga Institucionet ndërkombëtare në lëmin e prokurimit publik dhe të koncesioneve.
- Kujdes të veçantë do t'i kushtojmë zbatueshmërisë së strategjisë komunikuese me operatorët ekonomik dhe me publikun, në mënyre etike dhe profesionale.
- Duke qenë më transparent me operatorët ekonomik dhe të gjitha palët e interesuara, ne do të pasurojmë akoma më shumë uebfaqen tonë me informata të nevojshme mbi proceset e vendimmarrjes të vendimeve të Paneleve Shqyrtuese.
- Objektiv i OSHP-së do të jetë që, përmes ekspertëve vendor dhe ndërkombëtar në lëmin e prokurimit publik, të bëjë propozimin për ndryshim të Ligjit të Prokurimit Publik dhe atë për Partneritet Publik dhe Privat dhe të Koncesioneve, duke pasur gjithnjë parasysh pengesat, të cilat janë paraqitur në implementimin e këtij Ligji, si nga ana e operatorëve ekonomik, po ashtu edhe nga ana e Autoriteteve Kontraktuese, të interesuara për lëmin e Prokurimit Publik. Po ashtu, duhet pasur parasysh që propozimet e dhëna për ndryshim të Ligjit të jenë në pajtim me Direktivat e BE-së, ku ne si OSHP do të japim kontributin tonë përmes grupeve punuese që do të formohen për këtë qëllim.
- Organi Shqyrtues i Prokurimit do të jap kontributin e tij në ngritjen e nivelit të trajnimeve për certifikimin e zyrtarëve të prokurimit të Autoriteteve Kontraktuese, në bashkëpunim të ngushtë me KRPP-në dhe IKAP-in.
- Duke pasur parasysh që në funksionet dhe detyrat e OSHP-së është edhe hetimi i shqyrtimit të procedurave të prokurimit, OSHP do të fokusohet në gjetjen e mënyrës më të mirë për rritjen e stafit punues për arsye të kryerjes së këtyre detyrave.

- Organi Shqyrtues i Prokurimit do të ketë angazhim parësor për të forcuar marrëdhëniet me operatorët ekonomik me synim që t'i informojë mbi shërbimet që i ofron në mbrojtjen e të drejtave të tyre të ligjshme, duke inkurajuar moslejimin e favorizimeve dhe shkeljen e ligjit në procedurat e prokurimit publik apo të dhënies me koncesion dhe duke krijuar një sistem të sigurt të denoncimit të rasteve të korrupsionit të tyre.
- Viti 2010 do të jetë vit i dytë i funksionimit të plotë të OSHP-së dhe ne mirëpresim kërkesat, sugjerimet dhe vërejtjet eventuale nga Kuvendi për të raportuar mbi ecurinë e punës, pasi që jo vetëm se na keni mandatuar, por dhe kemi nevojë për mbështetjen e secilit prej jush për rekomandimet mbi ndryshimet e nevojshme ligjore në fushën e prokurimit publik dhe të dhënies me koncesion, të cilat dalin nga puna jonë në zbatim të kompetencave ligjore, si një institucion i pavarur, kompetent, i paanshëm në mbrojtje të të drejtave të çdo operatori ekonomik.

Kryetari i OSHP-së
HYSNI HOXHA



Prishtinë 2010